

# **RELACIONI TEKNIK**

**OBJEKTI:**

**“Sistemim, asfaltim i lulishtes ne lagjen Gjok Doci”**

- Mars 2026 –

## **HYRJE**

Ky dokument të konsiderohet si pjesë përbërëse e Dokumentacionit të Projekti Zbatimit dhe Preventivit Përfundimtar për objektin e mësipërm dhe si i tillë duhet të lexohet së bashku me vizatimet teknike dhe detajet e projektit.

Detyrat e këtij raporti janë:

Të evidentojë problematikat ndërtimore në objektin që është në studim, në kuadër të qëllimit të shprehur në Detyrën e Projektimit

Të shpjegojë qasjen për zgjidhjen e këtyre problematikave.

Të shpjegojë me fjalë zgjidhjen e propozuar nga ana e projektuesit.

## **Të përgjithshme**

Objekti në fjalë ka funksion permirsimin e infrastrukturës të lagjes, disiplinimin e levizjes së mjeteve në një drejtim dhe sistemimin e parkimit të tyre.

:

### **1. Shtresat rrugore të dëmtuara**

- Shtrati rrugor dhe sheshi funksional para dhe brenda territorit të lagjes paraqesin dëmtime të shumta (gropa, çarje, deformime), duke penguar qarkullimin e mjeteve.

### **2. Mungesa e sistemit efikas të kullimit të ujërave**

- Mungesë pikat grumbulluese dhe linja drenazhi përgjatë rrugës që të çojnë ujin në rrjedhje të kontrolluar.
- Prania e ujërave të qëndrueshme krijon rrezik dhe përkeqëson strukturën e shtratit rrugor.

### **3. Mungesa e ndriçimit funksional**

- Ndriçimi ekzistues është i amortizuar, me disa shtylla jashtë funksionit.
- Mungesë ndriçimi në zonat hyrëse dhe në hapësirat e parkimit.

### **4. Mungesë sinjalistike**

- Nuk ka sinjalistikë orientuese, paralajmëruese dhe ndarëse brenda territorit.
- Nuk ka tabela udhëzuese për drejtimet e lëvizjes.

### **5. Mungesë hapësirash të organizuara parkimi**

- Parkimi i mjeteve të banoreve dhe mjeteve është i çrregullt.
- Mungojnë vijëzimet, kufizimet dhe zonat e dedikuara.

Bashkia Diber kërkon të realizojë projektin e rikonstruksionit për objektin: “Sistemim, asfaltim i lulishtes në lagjen Gjok Doci”.

## **Qëllimi**

Ky relacion teknik është përgatitur në funksion të vlerësimit të situatës aktuale të territorit të Lagjes Gjok Doci, si dhe për të propozuar ndërhyrjet e nevojshme për rikonstruksionin e infrastrukturës rrugore, sistemit të kullimit, ndriçimit, sinjalistikës dhe organizimit të qarkullimit të automjeteve.

Përsa me siper projekti synon të zgjidhe :

- Përmirësimin e infrastrukturës rrugore në Lagjen Gjok Doci për të siguruar një qarkullim më të shpejtë, më të sigurt dhe më efikas të mjeteve.

## **TE DHENA TE PROJEKTIT**

### **Vendndodhja**

Gjate inspektimit vihen re probleme të cilat kërkojnë ndërhyrje sa më të shpejtë për t'i eliminuar dhe për të shmangur degradimin e mëtejshëm të këtij objekti.

Objekti lokalizohet ne Bashkine Diber.

Me poshte jepet nje imazh i vendodhje se objektit marre nga Google Maps

### **GJENDJA EKZISTUESE OBJEKTIT**



Pamje nga zona e projektit

## **Përshkrimi i projektit**

### **Zgjidhjet teknike të propozuara**

Në funksion të përmirësimit të të gjithë territorit, projekti parashikon ndërhyrjet në vijim:

- 1. Ndërtimi i parkingjeve dhe sistemimi i infrastruktures ne lagje.**
- 2. Rikonstruksioni i shtresave rrugore dhe asfaltimi i sheshit**
  - Heqja e shtresave ekzistuese të dëmtuara.
  - Vendosja e shtresave të reja:
    - Shtresa e lidhjes (binder) 6 cm
    - Shtresa asfaltike e veshjes 4 cm
- 3. Ndërtimi i sistemit të ri të kullimit**
  - Vendosja e kanaleve anësore.
  - Vendosja e pusetave shiu çdo 25–30 m.
  - Vendosja e tubacioneve te brinjezuara me diametër Ø200.
  - Riorganizimi i pjerrësive për largim natyral të ujërave sipërfaqësore.
- 4. Përmirësimi i sistemit të ndriçimit**
  - Vendosja e shtyllave të reja të ndriçimit me energji LED.
  - Instalimi i ndriçimit funksional përgjatë rrugës dhe zonave të parkimit.
- 5. Vendosja e sinjalistikës horizontale dhe vertikale**
  - Vendosja e sinjalistikës rrugore sipas rregullores në fuqi.
  - Vija ndarëse, shigjeta orientuese, vija kufizuese parkimi.
  - Tabela informuese për drejtimet, shërbimet dhe kufizimet.
- 6. Riorganizimi i hapësirave të parkimit**

# PLANIMETRIA E GJENDJES AKTUALE



# PLANIMETRIA E PRISHJEVE



# Planimetria e propozuar



ARK. ALBI KAZIA




# Planimetria e ujrave te bardha




# Detaje

## Detaji A




## Detaji B



ALBI KAZIA

# Detaje

## Detaji i shtresave asfaltike tek pjeset e reja



Asfalt ( lispel 4cm)
Binder 5cm
Stabilizant 15cm
Çakull 20cm
Toka natyrale

Tabela e volumeve per kanalin per 1 ml

Nr.	Emertimi	Nesi	Sipas
1	Qermeti i thes me makineri	m3	0.75
2	Tubi i betonizuar 200mm	m	1
3	Mbushje me rreze mbi nen dhe anash tubit	m3	0.11
4	Mbushje me material te gerrmuar	m3	0.2
5	Mbushje me çakull	m3	0.16
6	Shtresa stabilizanti 15cm	m3	0.14

ALBI KAZIA







**Ark. Albi KAZIA**